

# Ndikimi ekonomik i **Dokufest 2023**



Ndikimi ekonomik i  
Dokufest 2023

—  
Shkurt 2024

— **Përmbajtja**

1. Hyrje	4
2. Metodologjia	5
3. Pjesëmarrja në Dokufest 2023	6
4. Ndikimi ekonomik i Dokufest 2023	9
5. Supozimet në vlerësimin e ndikimit ekonomik	10
6. Shpenzimet ditore të vizitorëve të Dokufest 2023	13
7. Përfundim	19

## Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport, Instituti GAP ka bërë një vlerësim të ndikimit ekonomik të Dokufest 2023, si një prej ngjarjeve kryesore kulturore në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Ky vlerësim është bërë përmes mbledhjes së të dhënave parësore dhe dytësore dhe interpretimit të tyre në aspektin ekonomik. Të dhënat janë mbledhur përmes realizimit të dy anketave me qytetarë, ku në anketën e parë janë përfshirë vetëm ata që ishin blerës të biletave të Dokufest 2023, ndërkajq në të dytën vizitorët tjerë në Prizren (por që nuk ishin blerës të biletave).

Në vitin 2023, numri i përgjithshëm i vizitorëve të Dokufest ishte 16,756. Nga analizimi i shpenzimeve të vizitorëve del se ndikimi i Dokufest 2023 në ekonominë e Kosovës ishte rreth 4 milionë euro. Kjo tregon një rritje në krahasim me vitet e fundit pas pandemisë COVID-19, duke kontribuar kështu në sektorë siç janë gastronomia, akomodimi dhe transporti. Për më shumë, krahasuar me shpenzimet e bëra për organizimin e Dokufest 2023, gjetjet tregojnë se për çdo 1 euro të investuar janë gjeneruar 7.8 euro për ekonominë e Kosovës.

Gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

- Nga 16,756 vizitorë në Dokufest 2023, rreth 7,138 (43%) vizitorë ishin për herë të parë në festival, ndërsa 9,618 (57%) vizitorë kanë marrë pjesë edhe në edicionet e mëparshme. Rreth 5,050 (30%) prej tyre ishin shtetas ndërkombëtar që kishin ardhur në Kosovë enkas për të ndjekur festivalin.
- Arsyet kryesore të pjesëmarrjes në festival ishin: interesi për filmat (64%) dhe dëshira për të përjetuar atmosferën e festivalit (60%). Aktivitetet tjera më të preferuara në të cilat vizitorët marrin pjesë janë panelet e diskutimit dhe ekspozitat (për 55% e gjithsej të anketuarve);
- Për 76% të vizitorëve, përvoja e përjetuar në Dokufest 2023 ishte shumë e kënaqshme;
- Ndikimi ekonomik i Dokufest 2023 është gjithashtu rezultat i shpenzimeve të vetë festivalit, të cilat arritën shumën prej 516,858 euro;
- Nga analizimi i të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) rreth qarkullimit të bizneseve në Prizren gjatë muajit gusht 2023, (periudhës kur është organizuar festivali), rezulton se të hyrat e bizneseve janë rritur me 20% (gjithsej 117 milionë euro) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (98 milionë euro);
- Shpenzimet mesatare ditore të blerësve të biletave që janë banorë të Prizrenit gjatë Dokufest 2023 ishin 52.9 euro, ndërsa të pjesëmarrësve nga vendet jashtë Prizrenit ishin 101.17 euro;
- Pjesa më e madhe e shpenzimeve të vizitorëve nga vendet jashtë Prizrenit shkon për kategorinë e akomodimit (28%) dhe atë të ushqimit dhe pijeve (23%);
- Krahas vizitorëve që kishin ndjekur organizimet e Dokufest 2023, shumë qytetarë tjerë kishin vizituar Prizrenin tërhequr nga atmosfera e festivalit, edhe pse nuk ndjekin ndonjë organizim (me biletë). Këtë e tregojnë edhe gjetjet e anketës me jo-blerësit e biletave, ku rreth 70% prej tyre ishin të pranishëm për të shijuar atmosferën e festivalit, ndërsa rreth 85% e tyre deklaruan që gjasat ishin të larta për pjesëmarrje në festival vitin e ardhshëm. Kështu, Prizreni përfiton ekonomikisht edhe nga shpenzimet që bëjnë ky grup i qytetarëve gjatë qëndrimit në qytet.
- Nga jo-blerësit e biletave, mesatarja e shpenzimeve ditore të qytetarëve të Prizrenit është 37.06 euro, ndërsa e atyre jashtë Prizrenit dhe nga shtetet e jashtme është 71.24 euro. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të jo-blerësve të biletave ishin në kategorinë e ushqimeve dhe pijeve (rreth 37%), suvenireve dhe dhuratave (30.1%), akomodimit (20.6%), dhe transportit (11.9%).

# 1. Hyrje

Dokufest është një festival i filmit dokumentar të shkurtër që zhvillohet çdo vit në qytetin e Prizrenit që nga viti 2002. Me kalimin e viteve, ky festival ka bërë që Prizreni të bëhet një destinacion atraktiv turistik dhe kulturor. Dokufest tani është një nga festivalet më të rëndësishme të filmit në Ballkanin Perëndimor dhe në vitet e fundit ka rritur rëndësinë e tij edhe në arenën ndërkombëtare. Në vitin 2023, ky festival organizoi edicionin e 22-të duke shfaqur rreth 230 filma, ku 104 nga to ishin në njërën nga tetë kategoritë garuese për çmime.

Ky festival duke ofruar filma dokumentarë të shumtë, si dhe aktivitete tjera si diskutime, punëtori, koncerte, ekspozita, dhe aktivitete të tjera sociale, ka arritur të ketë një numër të madh të pjesëmarrësve nga e gjithë bota. Gjatë pjesëmarrjes në festival, vizitorët kanë mundësi të eksplorojnë bukuritë natyrore të Kosovës si dhe vendet e ndryshme historike. Përveç pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë të festivalit (blerësit e biletave), një numër i vizitorëve e vizitojnë qytetin e Prizrenit vetëm për të shijuar atmosferën e veçantë të qytetit. Në këtë mënyrë, ky festival sjellë përparësi të mëdha edhe në aspektin ekonomik, përveç atij kulturor, në Kosovë. Rrjedhimisht, është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i ndikimit ekonomik të Dokufest në Kosovë.

Në vitin 2023, Dokufest ka arritur të mbledhë 16,756 vizitorë nga Kosova dhe jashtë saj, përkatësisht mbi katër mijë vizitorë më shumë sesa në vitin 2021. Gjithsej, shuma e shpenzuar gjatë festivalit nga këta vizitorë vlerësohet të jetë 4 milionë euro, duke rezultuar në ndikim ekonomik më të lartë për 50% krahasuar me vlerësimin e ndikimit ekonomik të festivalit të bërë nga Instituti GAP për vitin 2021. Kjo rritje gjatë këtij viti ka ndodhur edhe për shkak të tejkalimit të situatës së rënduar nga pandemia COVID-19, me të cilën po përballej vendi gjatë vitit 2021. Ndërsa, nga analiza e ndikimit në Bruto Produktin Vendor (BPV), e cila heq efektin e importeve në llogaritje, del se vlera e ndikimit të Dokufest 2023 në BPV ishte 2.8 milionë euro. Bazuar në llogaritjet e kthimit në investime, del se për çdo 1 euro të investuar janë gjeneruar 7.8 euro për ekonominë e Kosovës. Ndërsa, nëse analizohet kthimi në investime vetëm nga fondet publike, del se për çdo 1 euro të investuar, janë gjeneruar 22.8 euro.

Sipas vlerësimit të Institutit GAP, përveç shumës së përgjithshme të shpenzuar, një ndër përparësitë kryesore të ndikimit ekonomik ka qenë edhe shpërndarja relativisht e barabartë e këtyre shpenzimeve nëpër sektorët e ndryshëm të vendit duke filluar nga industria e akomodimit, gastronomisë, transportit etj. Prandaj, organizimi i Dokufest 2023 ka shërbyer si një stimulues i rëndësishëm ekonomik jo vetëm i qytetit të Prizrenit, por i gjithë Kosovës.

## 2. Metodologjia

Në këtë raport, Instituti GAP ka bërë një vlerësim të ndikimit ekonomik të Dokufest 2023 përmes mbledhjes së të dhënave parësore dhe dytësore dhe interpretimit të tyre në aspektin ekonomik. Të dhënat janë mbledhur përmes anketimit të pjesëmarrësve të festivalit lidhur me shpenzimet e tyre gjatë pjesëmarrjes në festival, që është kryer nga kompania e specializuar për mbledhjen e të dhënave UBO Consulting, duke i kategorizuar ata në dy kategori: si blerës të biletave dhe jo-blerës të biletave.

Të dhënat parësore janë mbledhur nga një pyetësor i cili vlerëson shumën dhe mënyrën e shpenzimeve të vizitorëve gjatë ditëve dhe netëve të Dokufest 2023. Pyetësori që është përdorur ka për qëllim të zbërthejë shpenzimet e përgjithshme të vizitorëve nëpër sektorë të ndryshëm për të parë destinimin e tyre dhe rrjedhimisht për të vlerësuar ndikimin e festivalit nëpër këta sektorë.


Për të mundësuar një analizë më të gjerë të ndikimit ekonomik të këtij festivali, janë kryer dy anketa të ndara. Në anketën e parë pjesëmarrës ishin vetëm vizitorët që ishin edhe blerës të biletave, ndërkaq në të dytën vizitorët të cilët nuk ishin blerës të biletave. Në këtë mënyrë, është bërë një vlerësim i përafërt edhe i shpenzimeve të vizitorëve që vijnë në Prizren për të shijuar atmosferën e sjellur nga festivali. Për të siguruar saktësinë dhe përfaqësimin e të dhënave, për kategorinë e parë është përzgjedhur një mostër prej 650 vizitorësh që kanë blerë bileta. Në përzgjedhjen e mostrës, është zgjedhur çdo i/e pesti/a blerës/e i/e biletave në shtandet e shitjes së biletave deri sa është arritur mostra prej 650 vizitorësh. Marzha e gabimit në rezultatet e anketës së parë ishte 3.8%. Ndërsa, për kategorinë e dytë, është përzgjedhur një mostër prej 380 vizitorësh që kanë vizituar Prizrenin në atë kohë por nuk kanë blerë bileta. Në përzgjedhjen e mostrës, është zgjedhur çdo i pesti vizitor që nuk ka blerë bileta në qytetin e Prizrenit deri sa është arritur mostra prej 380 vizitorësh. Marzha e gabimit në rezultatet e anketës së dytë ishte 5%. Për të bërë llogaritjen e gjithsej shpenzimeve, nevojitet numri i përgjithshëm i vizitorëve si dhe proporcionet e vizitorëve sipas origjinës. Kjo e fundit ishte e rëndësishme sepse vizitorët me origjinë të ndryshme pritej të shpenzonin shumën të ndryshme gjatë festivalit.

Përveç anketave, vlerësimi ekonomik është bazuar edhe në të dhënat e mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për qarkullimin e deklaruar të bizneseve të Prizrenit gjatë muajve të organizimit të DokuFest 2023. Meqë të dhënat e ATK-së mund të mos shpërfaqin ndikimin e saktë për shkak të informalitetit në sektorin privat, të dhënat e marra nga pyetësori sigurojnë një vlerësim më të mirë të ndikimit ekonomik. Prandaj, në llogaritjen e vlerësimit të ndikimit ekonomik janë marrë fillimisht të dhënat e pyetësorit e më pas ato janë krahasuar me të dhënat e ATK-së për të parë nëse të dyja janë në përputhje me njëra tjetrën.

### 3. Pjesëmarrja në Dokufest 2023


Numri i përgjithshëm i vizitorëve në Dokufest 2023 sipas të dhënave të organizatorëve ishte 16,756 vizitorë. Gjatë Dokufest 2023, 7,138 vizitorë (43%) ishin për herë të parë në festival, ndërsa 9,618 (57%) vizitorë kanë marrë pjesë edhe në edicionet e mëparshme të Dokufest.

**Figura 1.** Numri i pjesëmarrësve në Dokufest 2023 – pjesëmarrësit e ri dhe ata të viteve të mëparshme




Nga 650 blerësit e biletave të anketuar, 82% prej tyre kishin njohuri se përveç dokumentarëve dhe filmave të shkurtër, festivali përfshin edhe aktivitete të tjera si punëtori, master klasa, ekspozita dhe panele të diskutimit, ndërsa 12% prej tyre nuk ishin në dijeni që festivali i ofron aktivitetet e tilla.

**Figura 2.** Njohuria e vizitorëve për aktivitetet e ofruara të Dokufest-it




Nisur nga kjo, ndër aktivitetet tjera më të preferuara për vizitorët, duke mos përfshirë filmat, mbeten Dokutalks me 54% të të anketuarëve që kanë deklaruar se kanë marrë pjesë apo planifikojnë të marrin pjesë në këto panele, pasuar nga ekspozitat (51%), punëtoritë (30%), master klasat (30%), dhe aktivitetet e tjera (8%).

**Figura 3.** Aktivitetet në të cilat vizitorët kanë marrë pjesë apo planifikojnë të marrin pjesë




Sa i përket arsyeve të pjesëmarrjes në festival, interesi për filmat dhe krijuesit e pranishëm ka qenë shtytja kryesore tek vizitorët e anketuar ku 64% prej tyre kanë deklaruar se kjo ka qenë një ndër arsyet kryesore të pjesëmarrjes në festival, pasuar nga dëshira për të përjetuar atmosferën e festivalit (60%), dëshira për të mësuar më shumë për kulturën dhe artin (44%), dëshira për të eksploruar Prizrenin dhe Kosovën (32%), dhe ardhja në festival për shkak të rekomandimit nga familjarët dhe shoqëria (28%).

**Figura 4.** Arsyet e pjesëmarrjes në festival




Rreth 5,050 vizitorë ishin shtetas ndërkombëtar që kishin ardhur në Kosovë enkas për të ndjekur festivalin. Nga kjo shifër 3,197 (63%) prej tyre ishin për herë të parë në Kosovë, ndërsa 1,856 (37%) prej tyre e kishin vizituar vendin edhe në të kaluarën. Nga ata që e kishin vizituar Kosovën edhe në të kaluarën, 1,031 e kanë vizituar Kosovën disa herë, ndërsa 825 prej tyre e kanë vizituar një herë.

**Figura 5.** Vizitorët ndërkombëtar të Dokufestit dhe ardhja e tyre në Kosovë



Edhe gjatë vitit 2023, Dokufest ofroi një gamë të pasur të aktiviteteve që arritën të përmbushin pritshmëritë e shumicës së vizitorëve. Në përgjithësi, 12,631 vizitorë (76%) ishin shumë të kënaqur me përvojën e përjetuar në festival, 2,887 vizitorë ishin të kënaqur (17%), 980 vizitorë ishin netural (6%), 206 vizitorë ishin disi të pakënaqur (1%), si dhe të pakënaqur me përvojën e përjetuar në Dokufest 2023 ishin vetëm 52 vizitorë.

**Figura 6.** Përvoja e vizitorëve në Dokufest 2023





## 4. Ndikimi ekonomik i Dokufest 2023

Dokufest 2023 është njëherit edhe edicioni i katërt i festivalit për të cilin Instituti GAP ka analizuar ndikimin ekonomik të tij. Gjatë analizës, është bërë ndarja e ndikimit direkt dhe ndikimit indirekt në ekonomi. Tek ndikimi direkt, janë paraqitur shpenzimet për realizimin e festivalit, e që konsiderohen që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi. Këtu përfshihen shpenzime sikurse ato për burimet njerëzore, pajisje, marketing, e të tjera. Ndërsa, ndikimi indirekt është llogaritur në tri mënyra duke u bazuar në disa supozime. Mënyra e parë e llogaritjes është bërë duke përdorur të dhënat e qarkullimit të bizneseve në Prizren për muajin gusht 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këto të dhëna janë paraqitur për të parë se si qarkullimi i bizneseve është rritur në atë periudhë, si rezultat indirekt i Dokufest 2023. Mënyra e dytë e llogaritjes së ndikimit ekonomik është bërë bazuar në rezultatet e anketës, duke llogaritur shpenzimet e vizitorëve gjatë ditëve të pjesëmarrjes në festival. Këto shpenzime janë ndarë në disa kategori të shpenzimeve si ushqim dhe pije, akomodim, transport, suvenire, e të tjera. Për më shumë, vizitorët janë ndarë sipas vendit të origjinës në disa kategori si qytetarë të Prizrenit, qytetarë të qyteteve tjera të Kosovës, nga diaspora dhe të huaj. Në këtë mënyrë, bazuar në numrin e përgjithshëm të vizitorëve të Dokufest 2023, janë llogaritur shpenzimet për konsum, e që shfaqin ndikimin indirekt të festivalit në ekonomi. Marrë parasysh faktin që një pjesë e madhe e produkteve të konsumuara në Kosovë janë të importuara, është bërë një llogaritje e shpenzimeve për konsum duke larguar efektin e importeve (si 30% e konsumit).<sup>1</sup> Rrjedhimisht, ndikimi ekonomik është llogaritur me një mënyrë të tretë, e cila paraqet ndikimin ekonomik të Dokufest 2023 në Bruto Produktin Vendor (BPV). Kjo metodë bën llogaritjen e ndikimit ekonomik të shpenzimeve të vizitorëve në Dokufest, pa përfshirë importet.

### 4.1. Ndikimi direkt

Për realizimin e Dokufest 2023 janë shpenzuar gjithsej 516,858 euro nga organizatorët e festivalit. Nga kjo shumë, 176,561 euro janë shpenzuar në burime njerëzore, akomodim dhe transport; 12,083 euro në marketing; 222,481 euro në pajisje, logjistike, të drejtat për shfaqje të filmave, mirëmbajtje, përkthim dhe titrim; dhe 105,733 euro në ndarje të çmimeve për fitues, performancë muzikore dhe shpenzime të tjera operative. Tek të gjitha kategoritë, krahasuar me vitin 2021, shpenzimet për organizimin e festivalit janë rritur me përjashtim të shpenzimeve për marketing, media sociale dhe software të cilat kanë shënuar rënie.

**Tabela 1.** Shpenzimet direkte për organizimin e Dokufest për vitet 2021 dhe 2023, në euro

Shpenzimet	2021	2023	Ndryshimi në %
Burime njerëzore, akomodim, transport	81,260 €	176,561 €	117%
Marketing, media sociale, software – web	58,532 €	12,083 €	-79%
Pajisje, logjistike, të drejtat për shfaqje të filmit, përkthim, titrim, printim	70,000 €	222,481 €	218%
Ndarja e çmimeve për fituesit, performanca muzikore dhe shpenzime të tjera operative	34,305 €	105,733 €	208%
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>244,097 €</b>	<b>516,858 €</b>	<b>112%</b>

<sup>1</sup> Në këtë vlerësim është zbritur efekti i importeve për shkak të nivelit të lartë të varësisë nga mallrat dhe shërbimet e huaja që ka vendi, duke e shumëzuar kështu vlerën totale të shpenzimeve me 70%.

## 4.2 Ndikimi indirekt

Ndikimi ekonomik i Dokufest 2023 është llogaritur duke i mbledhur gjithsej shpenzimet e vizitorëve në Dokufest 2023, gjatë pjesëmarrjes së tyre. Të dhënat e shpenzimeve janë marrë nga rezultatet e anketës së realizuar për këtë analizë dhe janë shumëzuar me numrin e vizitorëve gjatë periudhës së festivalit. Rrjedhimisht, janë bërë dy llogaritje të ndikimit ekonomik: ndikimi në shpenzime për konsum si dhe ndikimi në bruto produktin vendor (BPV). Në tabelën më poshtë, janë shfaqur të dhënat e llogaritjeve të ndikimit ekonomik të festivalit që Instituti GAP ka bërë ndër vite. Bazuar në këto të dhëna, në vitin 2023, festivali kishte ndikimin të madh në konsum me rreth 4 milionë euro, dhe në BPV-në e vendit me mbi 2.8 milionë euro. Ndërsa ndikim më të ulët në konsum dhe në BPV e ka pasur gjatë vitit 2021, e që ishte e pritshme si rrjedhojë e situatës së rënduar që mbizotëronte në vend si pasojë e pandemisë COVID-19.

**Tabela 2.** Ndikimi ekonomik i Dokufest ndër vite

	2011	2015	2021	2023
Ndikimi në shpenzime për konsum në euro	2,585,283 €	4,733,937 €	2,666,307 €	4,027,764 €
Ndikimi në bruto produktin vendor (BPV) në euro	2,068,226 €	2,461,647 €	1,866,415 €	2,819,434 €

## 5. Supozimet në vlerësimin e ndikimit ekonomik

- Supozimet e përdorura nga Instituti GAP për llogaritjen e ndikimit ekonomik të Dokufest 2023 janë:
- Numri i përgjithshëm i vizitorëve në Dokufest 2023 ishte 16,756 vizitorë. Nga ky numër, 37.8% e pjesëmarrësve ishin nga Prizreni; 20.6% shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë Prizrenit, 3.2% shqiptarë të diasporës që kanë ardhur vetëm për Dokufest 2023; 6.5% shqiptarë të diasporës që gjatë periudhës së Dokufest 2023 ishin duke vizituar të afërmit në Prizren; 1.7% shtetas ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë; dhe 30.2% vizitorë ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për Dokufest 2023.
- Shuma e shpenzuar për vizitorë është marrë nga anketat dhe vlerësohet se pjesëmarrësit nga Prizreni shpenzojnë mesatarisht 105.78 euro gjatë gjithë festivalit, personat që janë shtetas të Kosovës por jetojnë jashtë Prizrenit shpenzojnë mesatarisht 200.38 euro, shqiptarët e diasporës që kanë ardhur vetëm për Dokufest 2023 shpenzojnë 340.24 euro, shqiptarët e diasporës që gjatë periudhës së Dokufest 2023 ishin duke vizituar të afërmit në Prizren shpenzojnë 304.54 euro, shtetasit ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë shpenzojnë 319.27 euro, si dhe vizitorët ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për Dokufest 2023 shpenzojnë mesatarisht 417.41 euro.
- Në këtë llogaritje janë paraqitur dy projeksione, njëri që bën llogaritjen e ndikimit ekonomik që përfshin të gjitha shpenzimet (tabela 3) dhe tjetri i cili përfshin shpenzimet duke larguar efektin e importit (tabela 5).
- Ndikimi i Dokufest 2023 në shpenzimet për konsum vlerësohet të jetë rreth 4 milionë euro, ndërsa ndikimi në BPV është rreth 2.8 milionë euro. Ky nivel më i ulët i ndikimit në BPV krahasuar me shpenzimet për konsum rrjedh si pasojë e zbritjes së efektit të importeve nga vlerësimi për shkak të nivelit të lartë të varësisë nga mallrat dhe shërbimet e huaja që ka vendi. Kjo tendencë e lartë e vendit për të importuar, në këtë model është kalkuluar duke shumëzuar

shpenzimet e konsumit me një shifër prej 70%, shifër kjo që mund t'i atribuohet një kombinimi të faktorëve ekonomikë, gjeopolitikë dhe shoqëror të vendit.


6. Për dallim prej raporteve të kaluara, këtë vit në vlerësim është larguar efekti i multiplikatorit si pasojë e rritjes së ndjeshme të importeve.

#### 4.2.1 Ndikimi sipas qarkullimit të bizneseve

Ndikimi indirekt që Dokufest 2023 mund të ketë në ekonomi është shumë i madh për shkak të numrit të madh të turistëve dhe entuziastëve të filmit që sjell festivali në vend. Tërheqja e vizitorëve, veçanërisht e atyre jashtë vendit, sjell përfitime ekonomike të konsiderueshme. Kjo rritje në sektorin e turizmit, sjell me vete rritje të tregtisë dhe industrisë së shërbimeve, si restoranteve, hoteleve, dyqaneve të suvenireve, transportit, etj. Në këtë mënyrë, rriten mundësitë e përfitimit të bizneseve lokale nga shitja e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Si rrjedhojë, është bërë një llogaritje duke përdorur të dhënat e qarkullimit të bizneseve në Prizren për muajin gusht 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këto të dhëna janë paraqitur për të parë se si qarkullimi i bizneseve është rritur në atë periudhë, si rezultat indirekt i Dokufest 2023.

Nga të dhënat e ATK-së për qarkullimin e bizneseve në Prizren, del se në periudhën kur është mbajtur edicioni i Dokufest 2023, gjatë muajit gusht, deklarimi i qarkullimit ka shënuar një vlerë rekord me 117 milionë euro vetëm gjatë këtij muaji apo rreth 26.4 milionë më shumë (29%) sesa në muajin korrik të po të njëjtit vit, 2023. Ndonëse raporti nuk vie në përfundim se ekziston një lidhje kauzale mes Dokufestit 2023 dhe rritjes së qarkullimit të bizneseve, sepse nuk është bërë një modelim lidhur me këtë, shpenzimet e dokumentuara nga vizitorët e këtij festivali shkojnë në favor të ndikimit pozitiv të tij tek bizneset në Prizren. Nëse e krahasojmë vlerën e qarkullimit me vitin e kaluar në të njëjtën periudhë, të dhënat tregojnë se gjatë muajit gusht 2022, kjo vlerë ishte rreth 98 milionë euro. Pra, këtë vit, vërehet një rritje prej afër 20% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

**Figura 7.** Deklarimi i qarkullimit të bizneseve të Prizrenit në ATK gjatë muajve qershor-shtator, në euro



## 4.2.2. Ndikimi në shpenzimet për konsum

Shpenzimet e konsumit janë faktori kryesor që ndikon në rritjen e BPV-së. Nëse konsumatorët shpenzojnë më shumë për produkte dhe shërbime, kjo krijon një kërkesë më të lartë në treg që rrjedhimisht rrit edhe aktivitetin ekonomik të vendit. Për të llogaritur ndikimin ekonomik të Dokufest 2023 në vend, është bërë llogaritja e gjithsej shpenzimeve të vizitorëve të Dokufest 2023 gjatë ditëve të pjesëmarrjes në festival, bazuar në rezultatet e anketës së realizuar. Shpenzimet të cilat ishin të ndara sipas kategorive (ushqim dhe pije, akomodim, transport, të tjera) dhe sipas vendbanimit të vizitorëve, janë llogaritur si një shumë mesatare ditore. Më konkretisht, janë mbledhur shpenzimet mesatare ditore dhe janë kategorizuar sipas vendbanimit të vizitorëve. Për më shumë, bazuar në shpërndarjen e vizitorëve (proporcionin) sipas vendbanimit në mostrën e anketuar, shpenzimet mesatare ditore janë shumëzuar me numrin e vizitorëve për kategorinë përkatëse dhe numrin e ditëve të frekuentimit të festivalit.

Këto rezultate janë shfaqur në tabelën 3 më poshtë. Sipas llogaritjeve, ndikimi i përgjithshëm ekonomik i festivalit në shpenzimet për konsum ishte rreth 4 milionë euro. Në bazë të vendbanimit të vizitorëve, ndikimin më të madh në shpenzimet për konsum del ta kenë shtetasit ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për Dokufest 2023 me rreth 2.1 milionë euro, pasuar nga qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë Prizrenit me afro 700 mijë euro. Ndërsa, ndikimi më i ulët në shpenzimet për konsum del të jetë ai i shtetasve ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë me rreth 89 mijë euro, kjo si rezultat edhe i proporcionit të ulët të pjesëmarrjes së tyre në festival.

**Tabela 3.** Ndikimi në shpenzimet për konsum për vitin 2023, për 16,556 vizitorë<sup>2</sup>

Vendbanimi i vizitorëve	Shpërndarja e vizitorëve sipas vendbanimit	Shpenzimet mesatare ditore	Frekuentimi mesatar ditë/netë	Gjithsej shpenzimet
Prizreni	6,266 (37.8%)	52.89 €	2*	662,797.30 €
Qytetet tjera të Kosovës	3,413 (20.6%)	100.19 €	2*	683,913.59 €
Diaspora, shqiptarët e diasporës që kanë ardhur vetëm për Dokufest 2023	535 (3.2%)	100.07 €	3.4	181,988.60 €
Diaspora, shqiptarëte diasporës që gjatë periudhës së festivalit vizitojnë të afërmit në Prizren	1070 (6.5%)	89.57 €	3.4	325,786.32 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë	280 (1.7%)	96.75 €	3.3	89,453.98 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për Dokufest 2023	4992 (30.2%)	119.26 €	3.5	2,083,823.74 €
<b>Gjithsej ndikimi në shpenzimet për konsum</b>		<b>4,027,764 €</b>		

\*- Supozim në kalkulum

2 Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në festival është 16,756 vizitorë, ku 200 prej tyre i kanë pasur të mbuluara shpenzimet nga organizatorët e festivalit.

Sa i përket pjesëmarrjes në festival, nga 16,756 vizitorë të Dokufest në vitin 2023, del se 37.8% ishin nga Prizreni; rreth 20.6% të tjerë ishin shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë Prizrenit, 3.2% shqiptarë të diasporës që kanë ardhur vetëm për Dokufest 2023; 6.5% shqiptarë të diasporës që gjatë periudhës së Dokufest 2023 ishin duke vizituar të afërmit në Prizren; 1.7% shtetas ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë; dhe 30.2% vizitorë ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për Dokufest 2023.

## 7. Shpenzimet ditore të vizitorëve të Dokufest 2023

Sipas rezultateve të anketës së zhvilluar, shpenzimet mesatare ditore të banorëve të Prizrenit gjatë ditëve të zakonshme janë 18.58 euro, ndërsa gjatë ditëve dhe netëve të Dokufest 2023 shpenzimet mesatare ditore janë 52.89 euro, mbi dyfish më të larta. Ndërsa, vizitorët e jashtëm që mund të jenë shtetas të Kosovës nga qytetet tjera, nga diaspora apo edhe të huaj, shpenzimet mesatare ditore gjatë Dokufest 2023 i kishin 101.17 euro.


**Figura 8.** Shpërndarja e shpenzimeve ditore të banorëve të Prizrenit



Meqenëse shpenzimet ditore të vizitorëve që jetojnë jashtë Prizrenit janë rreth dyfish më të larta se të qytetarëve të Prizrenit, si dhe shpenzimet e akomodimit përbëjnë rreth 30% të gjithsej shpenzimeve të tyre, shpërndarja e shpenzimeve në figurën e mëposhtme është paraqitur vetëm për vizitorët jashtë Prizrenit.

Bazuar në të dhënat e figurës 9, pjesa më e madhe e shpenzimeve të vizitorëve të jashtëm shkon për kategorinë e akomodimit (28%), ushqimit dhe pijeve (23%), shpenzime të tjera (13%), biletave për filma (11%), biletave për DokuNights (11%), suvenireve dhe dhuratave (9%) dhe transportit (5%).

**Figura 9.** Shpërndarja e shpenzimeve të deklaruar të personave që jetojnë jashtë Prizrenit



Ndërsa, shpenzimet mesatare ditore të vizitorëve jashtë Prizrenit në euro sipas kategorive janë të shfaqura në tabelën 4 më poshtë. Këto kategori përfshijnë: ushqimin dhe pijet, akomodimin, transportin, suvenirët dhe dhuratat, argëtimin dhe rekreacionin, si dhe shpenzimet e tjera. Sipas të dhënave të shfaqura në tabelë, shpenzimet më të larta janë në kategorinë e akomodimit, me një mesatare ditore për person prej 26 euro, përcjellur nga kategoria e ushqimit me një mesatare prej 24 euro, shpenzimet e tjera të përgjithshme me 14 euro, biletat për filma me 12 euro, biletat për DokuNights me 11 euro, suvenirët dhe dhuratat me 9 euro, si dhe transporti me 6 euro. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve të përgjithshme për person gjatë festivalit del se vizitorët që jetojnë jashtë Prizrenit shpenzimet më të larta i kanë në kategorinë e akomodimit me 84 euro, pasuar nga kategoria e ushqimit dhe pijeve me 79 euro.

**Tabela 4.** Zbërthimi i shpenzimeve të vizitorëve që jetojnë jashtë Prizrenit, në euro

Kategoria	Ushqim & Pije	Akomodim	Transport	Suvenire dhe dhurata	Bileta për film	Bileta për DokuNights	Tjera	Gjithsej shpenzime
Mesatarja e shpenzimeve ditore për person	24€	26 €	6€	9 €	12€	11 €	14 €	101€
Gjithsej shpenzimet për një person gjatë festivalit	79 €	84 €	19 €	29 €	41 €	35 €	46 €	333€

### 4.2.3 Ndikimi në Bruto Produktin Vendor (BPV)

Bruto Produkti Vendor (BPV) mat vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda një vendi gjatë një periudhe kohore të caktuar, zakonisht një viti. Ky indikator ekonomik është shumë i rëndësishëm pasi shërben si një mjet kyç për të vlerësuar madhësinë dhe performancën e ekonomisë së një vendi. Në këtë raport, ndikimi në BPV është llogaritur si një mënyrë tjetër e matjes së ndikimit ekonomik duke mos përfshirë efektin e importeve. Meqenëse një pjesë e produkteve të konsumuara në Kosovë janë të importuara (rreth 30%)<sup>3</sup>, është bërë një llogaritje e shpenzimeve për konsum pa përfshirë importet, e cila jep ndikimin e Dokufest 2023 në BPV-në vendore.

Në tabelën 5 më poshtë, është llogaritur ndikimi i Dokufest 2023 si vlerë në bruto produktin vendor (BPV) në Kosovë. Kjo llogaritje është bazuar në shpenzimet mesatare ditore sipas kategorive, ditëve të qëndrimit apo frekuentimit të festivalit, si dhe numrit të vizitorëve. Sipas llogaritjeve të shfaqura në tabelën 5, ndikimi i përgjithshëm në BPV ishte rreth 2.8 milionë euro. Kjo shumë është llogaritur me 16,556 vizitorë (duke mos përfshirë ata të cilët i kanë pasur shpenzimet e mbuluara nga organizatorët e festivalit). Siç u përmend më lartë, në këtë vlerësim është zbritur efekti i importeve për shkak të nivelit të lartë të varësisë nga mallrat dhe shërbimet e huaja që ka vendi, duke e shumëzuar kështu vlerën totale të shpenzimeve me 70%.

**Tabela 5.** Ndikimi i Dokufest 2023 në Bruto Produktin Vendor (BPV) për vitin 2023, për 16,556 vizitorë<sup>4</sup>

Vendbanimi i vizitorëve	Shpërndarja e vizitorëve	Shpenzimet mesatare ditore	Frekuentimi mesatar ditë/netë	Gjithsej shpenzimet
Prizreni	6,266 (37.8%)	52.89 €	2*	463,958.11 €
Qytetet tjera të Kosovës	3,413(20.6%)	100.19 €	2*	478,739.51 €
Diaspora, shqiptarët e diasporës që kanë ardhur vetëm për Dokufest 2023	535 (3.2%)	100.07 €	3.4	127,392.02 €
Diaspora, shqiptarëte diasporës që gjatë periudhës së festivalit vizitojnë të afërmit në Prizren	1070 (6.5%)	89.57 €	3.4	228,050.42 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë	280 (1.7%)	96.75 €	3.3	62,617.78 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për Dokufest 2023	4992 (30.2%)	119.26 €	3.5	1,458,676.62 €
<b>Gjithsej shpenzime në Prizren / Kosovë (ndikimi direkt në BPV në afat të mesëm)</b>				<b>2,819,434 €</b>

\*- Supozim në kalkulim

3 Në këtë vlerësim është zbritur efekti i importeve për shkak të nivelit të lartë të varësisë nga mallrat dhe shërbimet e huaja që ka vendi, duke e shumëzuar kështu vlerën totale të shpenzimeve me 70%.

4 Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në festival është 16,756 vizitorë, ku 200 prej tyre i kanë pasur të mbuluara shpenzimet nga organizatorët e festivalit.



#### 4.2.4 Kthimi në investime

Sa i përket burimeve të financimit, në Dokufest 2023, gjithsej shuma e përgjithshme e financimit të festivalit ishte 516,858 euro. Nga këto, pjesa më e madhe e buxhetit ishte e financuar nga fondet publike me 176 mijë euro apo rreth 34% të gjithsej buxhetit. Pjesa tjetër ishte e financuar nga të hyrat private me 131,600 euro (rreth 25%), të hyrat nga shitja dhe shërbimet me 88,142 euro (17%), të hyrat nga projektet me 54,000 euro (11%), të hyrat nga ambasadat me 41,322 euro (8%), si dhe të hyrat e bartura me 25,794 euro (5%).

**Tabela 6. Burimet e financimit të festivalit, 2023**

Gjithsej financimi nga fondet	176,000 €
*Ministria e Kultures Rinisë dhe Sportit	100,000 €
*Komuna e Prizrenit	70,000 €
*Qendra Kinematografike e Kosovës	6,000 €
Ambasadat në Kosovë	41,322 €
Financimi nga fondet private	131,600 €
Të hyrat nga projektet Dokufest 2023	54,000 €
Të hyrat nga shitja dhe shërbimet	88,142 €
Të hyrat e bartura	25,794€
<b>Gjithsej financimet</b>	<b>516,858 €</b>

Bazuar në të dhënat e financimit dhe llogaritjet mbi ndikimin e festivalit në shpenzimet për konsum, është bërë edhe analiza e kthimit në investime. Për të realizuar këtë, është llogaritur një multiplikator<sup>5</sup> duke pjesëtuar vlerën e ndikimit të festivalit në shpenzimet për konsum prej 4 milionë eurove, me vlerën e gjithsej financimit të festivalit, 517 mijë euro. Nga kjo, vlera e multiplikatorit del të jetë 7.8. Rrjedhimisht, për çdo euro të investuar, janë gjeneruar 7.8 euro për ekonominë e Kosovës.

Nëse e analizojmë kthimin në investime vetëm nga paratë publike, del se është pothuajse 30% më i lartë. Meqenëse një e treta e financimit të festivalit është bërë nga fondet publike, sipas kalkulimeve del se kthimi në investime është 22.8. Më konkretisht, për çdo euro të investuar nga fondet publike, janë gjeneruar 22.8 euro për ekonominë e Kosovës. Pra, kthimi në investime është mjaft i lartë, si nga gjithsej fondet, si nga fondet publike.

#### 4.3 Ndikimi indirekt i vizitorëve jo-blerës të biletave


Përveç analizimit të të dhënave për pjesëmarrësit direkt të festivalit (blerësit e biletave), Instituti GAP ka analizuar edhe shpenzimet e pjesëmarrësve që ishin të përfshirë në mënyre indirekte (ata që nuk kanë pasur bileta). Kjo anketë e dytë ka pasur për synim që të shoh se sa është pjesëmarrja e atyre që e vizitojnë Prizrenin për shkak të ngjarjes së Dokufest 2023, ndonëse nuk marrin pjesë në ngjarjet e organizuara nga festivali, rrjedhimisht duke mos u regjistruar si vizitorë (veçmas që shpenzimet e tyre në këtë periudhë kanë ndikim ekonomik shtesë në vend).

<sup>5</sup> Multiplikatori në këtë rast është llogaritur duke pjesëtuar vlerën e ndikimit të festivalit në shpenzimet për konsum me vlerën e financimit të festivalit.




Për të realizuar këtë, është marrë një mostër prej 380 personave. Nga këta, 60% ishin për herë të parë në Dokufest dhe rreth 28% kishin interesim për filma dhe krijuesit që ishin prezent. Një numër i madh prej tyre (rreth 70%) kishin ardhur për të shijuar atmosferën e festivalit. Tutje, rreth 22% u shprehën se kishin ardhur për të mësuar më shumë për artin dhe kulturën, ndërsa rreth 27.4% kishin dëshirë për të eksploruar Prizrenin dhe Kosovën.

**Figura 10.** Arsyet e pjesëmarrjes në Dokufest 2023




Një tjetër vlerësim me rëndësi nga përgjigjet e anketuesve ishte edhe fakti që rreth 85% e tyre deklaruan që gjasat për pjesëmarrje në festival vitin e ardhshëm ishin të larta. Më konkretisht, rreth 33% prej tyre deklaruan që është shumë e mundur pjesëmarrja vitin e ardhshëm, ndërsa rreth 53% u shprehën që ishte e mundur.

**Figura 11.** Gjasat për pjesëmarrje në Dokufest vitin e ardhshëm



Sipas rezultateve të anketës, mesatarja e shpenzimeve ditore të qytetarëve të Prizrenit është 37.06 euro, ndërsa e atyre jashtë Prizrenit dhe nga shtetet e jashtme është 71.24 euro. Ngjashëm si më lartë, edhe këtu janë analizuar më tutje shpenzimet e personave që jetojnë jashtë Prizrenit për arsye që janë rreth dyfish më të larta se të qytetarëve të Prizrenit, si dhe kategoria e akomodimit përbën një pjesë të madhe. Për më shumë, nga këto shpenzime, pjesa më e madhe kanë qenë në kategorinë e ushqimeve dhe pijeve (rreth 37%), suvenireve dhe dhuratave (30.1%), akomodimit (20.6%), dhe transportit (11.9%).

**Figura 12.** Shpërndarja e shpenzimeve të personave që jetojnë jashtë Prizrenit sipas kategorive



Nga kjo anketë, janë analizuar edhe shpenzimet e qytetarëve të Prizrenit (jo blerës të biletave) në kategorinë e ushqimit dhe pijeve dhe transportit gjatë ditëve të festivalit, dhe në ditët tjera të vitit. Sipas përgjigjeve të pjesëmarrësve të anketës, shpenzimet mesatare ditore për ushqim gjatë festivalit janë 11.41 euro, ndërsa ditëve të tjera të rregullta 7.03 euro. Ndërsa, për kategorinë e transportit shpenzimet mesatare ditore gjatë ditëve të festivalit ishin 5.06 euro, ndërsa gjatë ditëve të rregullta 3.33 euro. Nga këto rezultate, vërehet një tendencë për rritje të shpenzimeve edhe e qytetarëve të Prizrenit gjatë ditëve të festivalit.

## 8. Përfundim

Dokufest ka bërë Prizrenin një destinacion tërheqës për turistët nga e gjithë bota. Ndër vite, interesimi i njerëzve dhe numri i pjesëmarrësve në festival ka qenë në rritje të vazhdueshme. Përveç pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në festival, Dokufest ka tërhequr mijëra vizitorë në qytet, të cilët vijnë edhe vetëm për të shijuar atmosferën dhe shpenzojnë për akomodim, ushqim, dhe aktivitete të tjera turistike. Kjo ka sjellur ndikim pozitiv në zhvillimin e sektorit të turizmit dhe njëkohësisht në aktivitetet e bizneseve vendore.

Bazuar në rezultatet e analizës së të dhënave që janë bërë nga Instituti GAP, ngjashëm me vitet e kaluara, edhe Dokufest 2023 ishte një ndër festivalet me ndikimin më të lartë ekonomik në vend. Në Dokufest 2023, festivali ka arritur të mbledhë rreth 16,756 vizitorë nga Kosova dhe vendet e ndryshme të botës. Për realizimin e tij, janë shpenzuar gjithsej 516,858 euro për shpenzime të pagave, akomodim, transport, marketing, logjistikë, ndarje të çmimeve e të tjera. Ndërsa, sipas llogaritjeve të bëra nga rezultatet e anketës, ndikimi ekonomik i Dokufest 2023 vlerësohet të jetë rreth 4 milionë euro. Ndërsa, ndikimi në bruto produktin vendor në Kosovë ishte rreth 2.8 milionë euro.

Bazuar në të dhënat e financimit dhe llogaritjet mbi ndikimin e festivalit në shpenzimet për konsum, del se për çdo 1 euro të investuar, janë gjeneruar janë gjeneruar 7.8 euro për ekonominë e Kosovës. Ndërsa, nëse analizohet kthimi në investime vetëm nga fondet publike, del se për çdo 1 euro të investuar, janë gjeneruar 22.8 euro.

Si përfundim, ndër vite, Dokufest ka tërhequr shumë pjesëmarrës nga shtete të ndryshme të botës dhe ka luajtur një rol kyç në fushën e kulturës në Kosovë. Për më shumë, ka shërbyer edhe si një stimulues i rëndësishëm ekonomik jo vetëm i qytetit të Prizrenit, por i gjithë Kosovës. Prandaj, sipas vlerësimit të bërë, ndikimi i tij ekonomik në vend ka qenë i konsiderueshëm.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)



